

Thirrje për aplikim për regjistrim në programin e doktoratës në “Shkenca Sociale dhe të Sjelljes”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare për vitin akademik 2024-2025

Programi i studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Shkenca Sociale dhe të Sjelljes”, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është program i riorganizuar i Doktoratës në “Shkenca Sociale” me Urdhër nr. 111, datë 04/03/2022.

Ky program bazohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, me nënfusha: Ekonomiks, Psikologji, Sociologji dhe Studime Kulturore.

AFATI I APLIKIMIT 19 DHJETOR 2024 – 10 JANAR 2025

KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT

Aplikanti duhet:

- Të ketë fituar diplomën “Master i shkencave” ose “Master i Arteve”, apo diplomë të barasvlershme të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente, në fushë të njëjtë ose të përafërt me studimet e doktoratës;
- Të ketë njohje të gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht) në nivelin B2, vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 vjet nga koha e lëshimit të tyre. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- Të ketë notë mesatare të përgjithshme në ciklin më të lartë të studimeve 8 e lart, e llogaritur në bazë të grup-lëndëve karakterizuese të programit të studimit;
- Të jetë personel akademik i Universitetit Europian të Tiranës, ose personel akademik në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë, ose personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
- Të marrë përsipër përbushjen e standardeve shkencore, akademike, ligjore dhe etike;
- Aplikanti duhet të hartojë një Projekt Propozim bazuar në fushat e detajuara të programit të doktoratës dhe projektit kërkimor të drejtuesit të grupit, preferuar nga ai për udhëheqje;

DOKUMENTAT E NEVOJSHME PËR APLIKIM

Aplikantët duhet të dorëzojnë pranë Koordinatorës së zyrës Doktorale, zyra 401B dosjen me dokumentacionin e kërkuar duke filluar nga data 19.12.2024 deri ne datë 10.01.2025.

Dosja duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë personale drejtuar Departamentit të Shkencave të Aplikuara, pranë Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;
2. CV personale dhe një listë e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes së aplikimit (në rastin kur personi që aplikon ka të tilla);
3. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, kopje të noterizuar të diplomës “Master i shkencave” (ose të një diplomë ekuivalente me të si “DND”), si dhe kopje të noterizuar të listës së notave për të gjitha nivelet e studimeve/diplomave;
4. Fotokopje e ID ose pasaportës;
5. Dy fotografi;
6. Dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;
7. Një propozim kërkimi në të cilin përcaktohet dhe emri i udhëheqësit shkencor;
8. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi origjinale ose të noterizuar të njohjes së gjuhës së huaj;

Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë.

Për më shumë informacion: shkolladoktorale@uet.edu.al; jola.shpuza@uet.edu.al